



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:232747
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837643

K.Dh.Sh II.nr.543/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Sheshin Nëna Terezë – ish ndërtesa e Gërmisë, në Prishtinë, kundër debitorit T.Q. B.I., me seli në fshatin Bellobrad, Komuna e Dragashit, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1122/23 të datës 30.11.2023, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1122/23 të datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1122/23 të datës 30.11.2023, në dispozitiv të

aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit T.Q. B.I., të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarrim P.nr.1399/21 i datës 06.10.2021, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gacaferi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarrimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit Nr. 001540 të datës 14.06.2019, ndërsa Përmbarruesi Privat ka nxjerr urdhrin përmbarrimor P.nr.1399/21 me datën 06.10.2021, me të cilin është detyruar debitori T.Q. B.I., që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 2,000.00 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të këtij propozimi.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar ndër të tjera se nga aktvendimi i gjykatës është pezulluar procedura kundërvajtëse dhe se me pezullimin e kësaj procedure nuk ka titull ekzekutiv, mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarrimor. I ka propozuar gjykatës që ta anulojë urdhrin përmbarrimor dhe të ndërpritet procedura përmbarrimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, ngase kemi të bëjmë me dy lëndë krejtësisht të ndryshme për nga koha e kryerjes së veprës kundërvajtëse. Në lidhje me pretendimet e debitorit se kjo procedurë e kundërvajtjes është pezulluar nga gjykata ka kundërshtuar të njëjtën duke theksuar se një pretendim i tillë nuk qëndron. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe ta miratojë urdhrin për përmbarrim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1122/23 të datës 30.11.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit T.Q. B.I., të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarrim P.nr.1399/21 i datës 06.10.2021, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Isa Gacaferi.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se dokumenti i lartcekur nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarrim të përcaktuara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, me çka rezulton se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat nuk i plotëson kushtet për përmbarrim që duhet t'i ketë dokumenti përmbarrimor, të parapara me nenin 24 par. 3 dhe 36 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se dokumenti mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarrimi nuk paraqet titull ekzekutiv ashtu siç

kërkohej me nenin 21 të LPP-së “*Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 36 par. 1 i cili përcakton se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbaues i dorëzohet edhe dokumenti përmbaues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbaueshmërisë për përmbaueshmëri*”, të LPP-së.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, dokumenti- Vendimi Nr. 001540 i datës 14.06.2019, nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm e as titull ekzekutiv, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë,

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta pasi që në këtë çështje juridike përmbaimore përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit i cili i nuk plotëson kushtet për përmbarim dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.ShII nr.543/24, me datë 18.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri

Numri i lëndës: 2021:232747
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05837643